



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

### Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës

Adresa: Rr.UÇK 2 - 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

### Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prishtinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje

me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

B1 Komuna në regjistrin e pasurisë kontabël/SIMFK nuk kishte evidentuar ende 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim, ish-objektin e Gjykatës së Apelit, ish-objektin e Gjykatës Komunale, ndërtesat ku ndodhen Drejtoria e Inspeksionit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, edhe toka e shpronësuar për interes publik, nuk ishte regjistruar si pasuri e Komunës.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë.*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

1 Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2020 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 4,830,940€ në kategoritë ekonomike jo adekuate.

Prej tyre, 3,520,117€ (pagesa për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike, deratizimin e podrumeve, dezinfektimin hapësinor, organizimin e festivaleve të ndryshme kulturore etj.) janë rezultat i keq planifikimit të buxhetit duke mbivlerësuar investimet kapitale dhe nënvlerësuar mallrat dhe shërbimet për këtë vlerë. Si dhe bazuar në pagesat me vendime gjyqësore/përmbartimore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë realizuar pagesa për paga jubilarë në vlerë prej 883,269€ dhe 427,554€ për investime kapitale (në total 1,310,823€).

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Vlen të theksohet se si pasoj e pagesave me vendime gjyqësore/përmbartimore, Komuna ka paguar shpenzime shtesë (përmbartimore/gjyqësore) në vlerë prej 557,398€.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prishtinës.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme<sup>3</sup>.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpалosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>4</sup>



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

#### Gjetja

Sipas nenit 6 dhe 10 të Rregullores me nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë - "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrat e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj (SIMFK dhe e-Pasuri) dhe të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimit duhet të regjistrohen në regjistra kontabël pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara".

- Edhe më tutje mbesin të paregjistruara objektet si në vijim: 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim, ish-objekti i Gjykatës së Apelit, ish-objekti i Gjykatës Komunale, gjithashtu edhe ndërtesat ku ndodhen Drejtoria e Inspeksionit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, edhe toka e shpronësuar për interes publik, nuk figuron e regjistruar në regjistrin kontabël/SIMFK, si pasuri e Komunës.
- Komuna nuk përdorë sistemin e-Pasuria, ky sistem është jofunksional për shkak të problemeve në mirëmbajtjen e tij (përgjegjësi e MAP-it). Të dhënat për pasuritë nën 1,000€ mbahen në data bazë të brendshme të Komunës, në formë të Excel-it. Megjithatë ky aplikacion nuk ka siguri për shkak se mund të bëhen gabime apo ndryshime të pa autorizuar. Për këtë çështje Komuna kishte bërë kërkesë në MAP për ta funksionalizuar sistemin, mirëpo Ministria nuk kishte bërë asgjë në këtë drejtim.

Sipas zyrtarëve komunal pritet që gjatë vitit 2021 të rregullohet kjo çështje, duke integruar tabelën me të dhënat e plotësuara (edhe për vitin 2020). Ndërsa për regjistrimin e objekteve të cilat janë në pronësi të Komunës theksojnë se duhet të formohet një komision profesional për ti vlerësuar fillimisht, pastaj të evidentohen në regjistrat përkatës.

#### Ndikimi

Mosfunksionimi i sistemit e-Pasuria pamundëson menaxhimin dhe kontrollin efektiv të pasurisë nën 1,000€. Po ashtu, mbajtja dhe evidentimi manual i të dhënave paraqet rrezik për lëshimin e gabimeve dhe ofron mundësi edhe të keqpërdorimit të këtyre pasurive. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, ndikon në informimin e pasaktë të palëve të interesit.

#### Rekomandimi B1

Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të merren të gjitha veprimet e nevojshme në bashkëpunim me Ministrin e linjës për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



## 2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Të hyrat

Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë 29,258,367€, kurse realizimi ishte në vlerë prej 24,963,214€ apo 85% krahasuar me planin. Të hyrat ishin realizuar nga tatimi në pronë, nga lejet e ndërtimit, nga dhënia në shfrytëzim e pronës komunale etj. Po ashtu, Komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat në trafik, gjykatat dhe Agjencioni i pyjeve në vlerë totale prej 2,072,881€. Vlen të theksohet se në këtë vit krahasuar me vitin paraprak Komuna ka arkëtuar 4 milion euro më pak të hyra apo shprehur në përqindje ka realizim më të ulët për 12% se në vitin 2019. Arkëtimi më i ulët ishte tek tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, ndërrim destinimi i tokës, shfrytëzimi i hapësirës publike etj.

### Çështja B2 - Shqyrtimi i vonuar i kërkesave për pajisje me leje të ndërtimit dhe leje mjedisore

#### Gjetja

Neni 17 pika 1.2 i Ligjit të ndërtimit me Nr. 04/L-110 cakton se: "Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III". Po ashtu, sipas nenit 11 të Udhëzimit administrativ me nr. 01-2017-Për dhënien e lejeve mjedisore komunale: "Vendimi për miratim ose refuzim të LMK-se i nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë përkatëse, lëshohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës". Gjatë auditimit konstatuam si në vijim:

- Komuna nuk ka respektuar afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, këto leje ishin lëshuar me vonesë. Në 13 nga 18 mostrat e testuara të lejeve të ndërtimit, kemi identifikuar se vonesat në shqyrtim të këtyre kërkesave ishin nga një deri në 11 muaj.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i numrit të madh të kërkesave për leje të ndërtimit, mos mbajtja e lëndëve në mënyrë të organizuar si dhe stafit të pamjaftueshëm. Zyrtarët komunal kanë shtuar se "kriteri ligjor i ditëve për lëshimin e lejeve të ndërtimit, është shumë ambicioz, në raport me numrin e kërkesave dhe kapaciteteve njerëzore në Drejtorinë e urbanizmit, kjo ka ndikuar që lëndët dhe lëshimi i lejeve të ndërtimit të bëhen me vonesë".

- Vonesa kishte edhe në lëshimin e lejeve mjedisore, në pesë raste kemi identifikuar se vonesat ishin nga një deri në katër muaj e gjysmë.

Shkak për këtë, sipas zyrtarëve komunal janë mungesa e kapaciteteve njerëzore brenda Drejtorisë së Planifikimit Strategjik (e sidomos sektori për lëshimi e lejeve mjedisore komunale) për ti përfunduar me kohë të gjitha lëndët (kërkesat) për Leje mjedisore komunale.

#### **Ndikimi**

Shqyrtimi i kërkesave me vonesë nga autoritetet komunale, dëmton marrëdhënien ndërmjet Komunës dhe aplikuesve, dhe paraqet parregullsi ligjore. Kjo po ashtu ndikon edhe në arkëtimin e vonuar/shtyrë të të hyrave, që burojnë nga këto shërbime, për shkak të vonesave nga zyrtaret kompetent, në ofrimin e këtij shërbimi që paguhet nga aplikuesit.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet sigurojë se zyrat përgjegjëse kanë staf të mjaftueshëm në dispozicion dhe shqyrtimi i kërkesave për leje mjedisore dhe atyre ndërtimore bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në të kundërtën duhet të shqyrtohet mundësia e angazhimit të kuadrove shtesë në këto departamente.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara**

#### **Gjetja**

Sipas nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, sipas Statutit të Komunës neni 33.2- a, dhe Ligjit 06/L-092 - Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës vihet në pah mundësia/mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.

- Në vitin 2014 Komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat në “Zonën Industriale”. Të paktën 37 parcela të kësaj zone me rreth 6 hektarë, shfrytëzohen nga biznese të ndryshme pa asnjë kompensim ndaj Komunës. Komuna ka humbje financiare për shkak se nuk inkason të hyra nga qiraja për këto parcela që shfrytëzohen pa rentë. Kjo çështje është ngritur edhe në raportin e vitit të kaluar dhe vazhdon të mbetet e pazgjidhur. Megjithatë, nga Komuna nuk është ofruar ndonjë shpjegim konkret, pse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ta adresuar këtë çështje.
- Në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal, në vitin 2007 ishin dhënë me qira 21 banesa për ish këshilltarët komunal. Ndërsa, me vendimin e komisionit për çështje banesore në vitin 2008 ishin dhënë edhe 22 banesa tjera me qira për punëtorët administrativ. Në dy rastet sipas kontratave afati i shfrytëzimit ishte për periudhën 10 vjeçare.

- Prej tyre, kemi testuar katër raste dhe kemi gjetur se këto kontrata kanë skaduar dhe të njëjtat nuk janë vazhduar më, edhe pse qiramarrësit vazhdojnë ta shfrytëzojnë pronën publike/banesat. Përveç kësaj edhe pse kompensimi ishte minimal (0,30€/m<sup>2</sup>) pagesa e qirasë nuk ishte bërë me kohë të rregullt dhe figuronin borxhe të akumuluar nëpër vite në vlerë 15,874€<sup>6</sup>.

Edhe përkundër rekomandimit të përsëritur për vite me radhë, menaxhmenti ende nuk kishte ndërmarr masa. Sipas deklarimit të Komunës, aktualisht po zhvillohet procesi i evidentimit të gjendjes aktuale të këtyre pronave, që më pas do të trajtohen sipas ligjit dhe rregullave në fuqi.

### **Ndikimi**

Mungesa apo edhe skadimi i kontratave për shfrytëzim të pronës, e privon Komunën nga e drejta për të kërkuar të hyrat nga qiratë, dhe nga e drejta për të ndjekur procedurë gjyqësore/përmbartimore për llogarit e pa arkëtuara të qirasë. Paaftësia e Komunës për ta zgjidhur situatën vite me radhë edhe përkundër zotimeve me planet e veprimit, ka krijuar hapësirë që kjo pasuri të keq menaxhohet, keqpërdoret për shkak se nuk ka sjell përfitime të pritura (të hyra) dhe ka krijuar llogari që vështir janë të arkëtueshme.

**Rekomandimi B3** Kryetari, duhet ti përmbahet zotimeve sipas planit të veprimit të përgatitur nga vet Komuna që çështja e këtyre pronave të zgjidhet duke përdor të gjitha mundësit ligjore për menaxhimin e këtyre pronave. Të siguroj se pronat komunale do të ofrohen në shfrytëzim nëpërmes një procesi transparent që do të rezultojë me kontrata valide, dhe Komunës si titullar i pronës publike duhet ti sjellin përfitime maksimale.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Parregullsi në faturimin e tatimit në pronë****Gjetja**

Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Zbritja për vendbanimin parësor, paraqet: “Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në Komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) Euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit”.

- Në tri nga gjashtë mostrat e testuara, Komuna ka lejuar zbritjet prej 15,000€ duke i evidentuar si vendbanime parësore për dy a më shumë prona në pronësinë e një tatimpaguesi, për këto raste ishte bërë nën-faturim në vlerë prej 1,395€<sup>5</sup>. Nga analiza e bazës së shënimeve të Protax-it kemi konstatuar se edhe në 60 raste tjera (prona/objekte të tatim-paguesve), ju ishte bërë zbritja e parregullt (që nuk lejohet me ligj) të vendbanimit parësor prej 15,000€ dhe Komuna për arsye të këtij nën-faturimi ka humbje financiare rreth 10,000€.
- Kurse në tri mostra tjera, kemi gjetur se është bërë mbi-faturim në vlerë prej 67.5€, duke mos u aplikuar zbritja adekuate e vendbanimit parësor të një prone (objekti) për tatimpaguesit. Nga analiza e bazës së shënimeve Protax, si rezultat i mos zbritjes së vendbanimit parësor prej 15,000€ të një prone për tatimpaguesit, Komuna ka mbi-faturuar 350 tatimpagues tjerë në vlerë prej 7,875€<sup>6</sup>.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos deklarimit të vendbanimit parësor nga ana e tatimpaguesve dhe mos vlerësimit (ri anketimit) gjatë fazës së inspektimit nga ana e anketuesve në teren.

**Ndikimi**

Faturimi i parregullt duke i lejuar zbritjen pa bazë ligjore ka rezultuar me më pak fonde nga të hyrat për Komunën, ndërsa në anën tjetër për shkak të mos aplikimit të zbritjes që parashihet me Ligj, tatimi më i lartë padrejtësisht i është faturuar tatimpaguesve. Kjo gjithashtu mund ta vendos Komunën para një situatë që të jetë subjekt i padive nga tatimpaguesit, për shkak të ngarkesave të parregullta tatimore.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të monitoroj se procesi i inspektimit/verifikimit të pronave bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu duhet të siguroj se politikat e komunikimit me palët e interesit/tatimpaguesit janë duke funksionuar me qëllim të azhurnimit të bazës me të dhëna të sakta sa i përket aplikimit/mos aplikimit të zbritjeve të lejuara sipas kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 22,661,142€, deri në fund të vitit janë shpenzuar 18,711,442€ apo 83% e buxhetit. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese tjera, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të auto rrugëve, ngrohje qendrore, furnizime për zyre, etj. Ne kemi testuar 70 mostra në vlerë totale 3,261,541€ përmes testimit substancial dhe pesë mostra në vlerë 632,485€ përmes testeve të pajtueshmërisë. Nga buxheti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve janë paguar edhe shërbimet kontraktuese ndërlidhur me angazhimin e punonjësve përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV). Në vitin e kaluar është trajtuar çështja e MSHV-ve ku numri i të angazhuarve në fund të vitit 2019 ishte 210, dhe për këtë kemi dhënë rekomandimin përkatës. Të angazhuar përmes MSHV kishte edhe gjatë vitit 2020, por se numri i të angazhuarve sipas listave që janë ofruar kishte rënë në 116, kryesisht punonjësit ishin angazhuar në Drejtorinë e Urbanizmit, Kuzhinën Qendrore, Drejtorinë e Kulturës, Zyrën e Financave, Anëtar të komisioneve etj. Angazhimet e tyre ishin bërë për periudha të ndryshme deri në 6 muaj, e në disa raste ishin ri vazhduar edhe për muaj tjerë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për zyrtarët publik, dhe me përfundimin e afatit të caktuar me marrëveshje, ato janë ndërprerë, dhe në rastet kur ka qenë e nevojshme angazhimi ishte bërë përmes kontratave për punë specifike me afat prej 120 ditëve.

### Çështja B4 - Parregullsi në menaxhim e shpenzimeve dhe të kontratave publike

#### Gjetja

LMFPP dhe Rregulla financiare nr.01-2013 Shpenzimi i parasë publike përcaktojnë elementet thelbësore të shpenzimit të parasë publike, siç janë, ndarja buxhetore, alokimi, zotimi, prokurimi publik, obligimi dhe pagesat. Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti ose marrëveshje nuk ekzekutohet si pagesë, nëse dokumenti apo marrëveshja e këtillë që rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuar me dispozitat e LMFPP.

Gjithashtu me pikën 61 të Rregullës dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik janë përcaktuar përgjegjësit e menaxherit të kontratës. Menaxheri i kontratës ka përgjegjësi të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit kontraktues të specifikuar me kontratë, dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë.

- Te kontrata publike kornizë (36 muaj) “Pastrimi i objekteve shkollore: Abdyl Frashëri; 7 Shtatori; Prenk Jakova; Eqrem Qabej; Hoxhë Kadri Prishtina; Gjimnazi Matematikor; Shkolla Model” në vlerë totale indikative 456,282.36€ (+/-30%), hapësirat e brendshme për dy shkolla ishin shtuar për 4,706 m<sup>2</sup> (4,706m<sup>2</sup> x 0.46€ = 2,165€/muaj) pas kërkesës së kontraktuesit dhe aprovimit nga menaxheri i kontratës, me arsyetimin se hapësirat në m<sup>2</sup> në paramasën e dosjes së tenderit nuk ishin të sakta. Dëshmitë për këto ndryshime ishin të mangëta. Ne gjetëm vetëm dy

dokumente/tabela me shifra të ndryshuara të hapësirës së brendshme nga dy shkollat. Nuk na është ofrua ndonjë dokument tjetër apo raport nga ndonjë komision vlerësues që kishte matur hapësirat e shkollave, apo çertifikatat e pronës/shkollës me të cilën do të dokumentohej sipërfaqja reale e objektit.

Për këto ndryshime ishte nënshkruar një Amandamentim plotësues i kontratës, 11 muaj pas nënshkrimit të kontratës bazë. Me Amandamentim ishte aprovuar pagesa e hapësirave shtesë për çdo muaj (që nga fillimi e deri në përfundim të kontratës 3 vjeçare). Komuna ka paguar retroaktivisht për 10 muaj shërbimet e pastrimit për hapësirat shtesë në vlerë 38,023€<sup>7</sup>.

- Me qëllim të arkivimit dhe ruajtjes së dokumenteve zyrtare, Komuna kishte shfrytëzuar shërbimet e arkivimit nga një kompani private. Shpenzimet për shërbime të arkivimit<sup>(11)</sup>, bartjes dhe ruajtjes së përkohshme të dokumenteve, në vlerë 20,710€ janë paguar pa kontratë publike apo marrëveshje ndërmjet Komunës dhe OE. Nuk kishte as raport të monitorimit apo menaxhimit nga përfaqësuesi i Komunës për të siguruar saktësinë dhe sasinë e pakove të arkivuara dhe shërbimeve përcjellëse të cilat janë përfshirë në faturë. Konstatimi dhe pagesa për këtë lëndë është aprovuar nga ZKA.
- Pagesa për “Platformën elektronike për këshillim dhe orientim në karrierë” e shfrytëzuar nga shkollat e Komunës së Prishtinës, në vlerë prej 6,844€, kishte përfshirë edhe pjesën e TVSH-së në vlerë 1,044€. Në Memorandumin e Mirëkuptimit i nënshkruar nga DKA me dt.11.07.2017, në pikën 3.4 është përcaktuar çmimi fiks 100€ për një shkollë, në vit. Shërbimet ishin shfrytëzuar nga 58 shkolla dhe sipas çmimit, kostoja e shërbimit duhej të ishte 5,800€ në total.
- Për kontratën “Furnizim me pako ushqimore për familjet në kushte të rënda ekonomike”, në vlerë prej 112,800€, menaxheri dhe mbikëqyrësi i kontratës nuk kishin dëshmuar si duhet procesin e shpërndarjes së pakove ushqimore. Listat e shpërndarjes për familjet përfituese nuk ishin të organizuara për të dëshmuar qartë numrin e përfituesve, po ashtu edhe sasinë e përmbajtjes së ushqimit në pako. Plani i menaxhimit të kontratës (PMK) nuk ishte azhurnuar me informacione të mjaftueshme rreth realizimit të kontratës (ashtu siç kërkohet në rubrikat përkatëse të PMK-së), lidhur me fillimin, progresin dhe përmbylljen e kontratës.
- Te kontrata për “Furnizim me kiflet për nxënësit e klasave 1-5”, në raportet e pranimit të nënshkruara nga përfaqësuesit e shkollave nuk ishte specifikuar lloji i shujtës (kifleve) të

pranuara, ndonëse shujtat (kiflet) sipas kontratës kishin çmime të ndryshme. Po ashtu, si rezultat i mbikëqyrjes së pamjaftueshme, shkollat kishin vazhduar pranimin e ushqimit edhe pas skadimit të kontratës. Vlera e tejkaluar e furnizimeve pa kontratë ishte 10,365€, dhe pas konstatimit të menaxherit të kontratës kjo vlerë nuk është paguar.

- Te “Furnizimet me material higjenik”, në vlerë prej 8,850€, fletë dërgesat nuk ishin nënshkruar nga menaxheri dhe mbikëqyrësit e kontratës, por vetëm nga zyrtarët e shkollave, por kishte raste kur pranimet ishin bërë nga një zyrtar i vetëm. Si rezultat i mbikëqyrjes jo adekuate, shkollat kishin pranuar furnizime përtej kontratës në vlerë prej 2,011€ e cila ishte aprovuar nga menaxheri dhe mbikëqyrësi i kontratës, ndonëse kjo vlerë shtesë nuk ishte paguar nga zyra e financave.

Shkak i ndodhjes së kësaj situate, është mungesa e kontrolleve të brendshme dhe monitorimi i pamjaftueshëm nga menaxherët dhe mbikëqyrësit e kontratave.

#### **Ndikimi**

Mos zbatimi i kontratave sipas kushteve të kontraktuara, ka shkaktuar kosto të pa arsyeshme buxhetore. Mungesa e kontratës publike mund të ndikojë që të pranohen shërbimet dhe se çmimet mund të mos jenë të favorshme. Gjithashtu ka dështuar menaxhimi i kontratave në dy raste, për furnizim jashtë kontraktuale edhe pse pagesa nuk është ekzekutuar, komuna ka hyrë në obligime që mund të sjellin edhe kosto shtesë për shkak të përballjes me padi nga ana e kontraktuesve në të ardhmen.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë që të mos realizohen pagesa pa kontratë publike. Lëndët të kompletohen me dokumentacionin e nevojshëm para se ato të dërgohen për pagesë. Pranimi i mallrave dhe shërbimeve të bëhet nga zyrtarët e autorizuar për menaxhim dhe mbikëqyrje të kontratave.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Mangësi në zhvillimin e procedurës së prokurimit****Gjetja**

Neni 35 i LPP përcakton rastet kur AK mund të aplikojë procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë. Pika 3 e nenit 35 thekson se "Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.

- Përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ishte nënshkruar kontrata gjashtë mujore për "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e Komunës së Prishtinës" në vlerë prej 232,373€. Për negociim ishte ftuar kontraktuesi paraprak, përkatësisht vetëm një operator ekonomik, ndonëse ky lloj shërbimi ofrohet edhe nga kompanitë tjera. Raporti i vlerësimit të tenderit nuk ishte plotësuar me të dhënat e nevojshme rreth negociatave siç kërkohet formalisht, por vetëm ishte nënshkruar nga anëtarët e komisionit në formën e shabllonit, me disa plotësime të pakta rreth kompanisë dhe çmimit të ofruar.

Kjo procedurë e prokurimit ishte përdorur për shkak se aktiviteti i prokurimit i zhvilluar përmes procedurave të hapura në vitin 2019, ishte ende në fazën ankimore në OSHP. Sipas zyrtarit të prokurimit, nuk ishin ftuar OE tjerë, me qëllim të evitimit të ankesave të mundshme nga ofertuesit, dhe nevojës për shërbime të vazhdueshme të sigurimit fizik në objektet e Komunës.

**Ndikimi**

Përdorimi i procedurës së tenderimit me negociim, ka eliminuar konkurrencën e mirëfilltë të operatoreve në treg, që mund të ofrojnë të njëjtin shërbim me një çmim më të favorshëm.

**Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret në rrethana të arsyeshme sipas LPP, duke eliminuar mundësin e diskriminimit të operatoreve. Për shërbimet e sigurimit, me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës të negociojë termat e kontratës me më shumë operator ekonomik që në treg ofrojnë shërbimin e njëjtë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 13,670,900€, prej tyre ishin shpenzuar vetëm 5,061,086€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimin e OJQ-ve, ndërmarrjeve publike lokale, dhe përfituesve individualë. Kemi testuar 12 mostra për teste substanciale në vlerë totale 246,926€ dhe katër mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja B5 - Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare / subvencionim

**Gjetja** Rregullorja MF - 04/2017- Për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 – “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM-së.

Komuna nuk ka përgatitë planin e konsoliduar vjetor të mbështetjes financiare për OJQ për vitin 2020. Përveç Drejtorisë për rini dhe sport të cilët kishin përgatitur planin vjetor për subvencionim, nuk na janë ofruar dëshmi se edhe drejtoritë tjera kishin përgatitur planet e tyre vjetore për subvencionim të projekteve.

Shkaku përse ka ndodhur kjo është mungesa e kontrolleve efikase në përmbushjen e kërkesave për hartimin e planit vjetor të subvencioneve dhe përmbushjen e kërkesave për raportim të planit në ZKM.

**Ndikimi** Mungesa e planit vjetor të subvencioneve pamundëson informimin me kohë të palëve të interesuara rreth programit vjetor dhe objektivave që synohen të arrihen përmes financimit të projekteve.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A3 - Parregullsi në procesin e subvencionimit****Gjetja**

Komuna e Prishtinës ka të aprovuar Rregulloren për subvencione 01-020/01-19410/18, përmes së cilës janë përcaktuar kërkesat dhe procedurat për subvencionim. Gjithashtu, Rregullorja MF 04/2017 - Për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin. Sipas nenit 23, pika 2 - "Përfituesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit".

- Te subvencioni për “Përkrahje fermerit për dëmet e shkaktuara në bujqësi” në vlerë prej 48,500€, aplikuesi/fermeri kishte kërkuar ndihmë financiare nga Komuna për dëmet e shkaktuara nga breshri/shiu për kulturën bujqësore (specat) në 80% të sipërfaqes prej 4.3ha. Për vlerësimin e dëmit Komisioni vlerësues kishte përgatitur një raport, ku kishin vlerësuar dëmin prej 80% apo 37,800€ për sipërfaqen 4.5ha dhe përveç kërkesës për kompensim të dëmeve sa kishte kërkuar aplikuesi, komisioni kishte përfshirë në raportin vlerësues edhe 9ha shtesë të kulturës bujqësore (patate për 4.5h-50% dhe 4.5h-80%) në vlerë 40,950€ për kompensim të dëmit. Raporti i përgatitur gjatë vizitës në teren për vlerësimin e dëmeve përmbante vetëm informatën mbi hektarët, përqindjen e dëmit dhe disa fotografi. Komisioni i kishte propozuar MBPZHR-së pagesën e dëmeve në vlerë prej 78,750€. Në fund të vitit Komuna nga buxheti i saj kishte paguar në llogari të fermerit 48,500€; dhe
- Përfituesi i subvencionit për projektin “Table Stories” në fushën e kinematografisë, në vlerë prej 6,000€, nuk e kishte realizuar projektin e financuar brenda afatit të paraparë në kontratë që ishte deri me dt.31.12.2020. Sipas nenit 5 parashihet edhe shkëputja e kontratës në rast të tejkalimit të afatit të pajustificueshëm për realizim, dhe sipas nenit 6 bartësi i projektit obligohet që shumën e pranuar dhe kamatën ligjore t’ia kthej Komunës. Komuna nuk kishte monitoruar nëse projekti i subvencionuar po realizohet nga përfituesi dhe nuk kishte pranuar njoftim zyrtar për mos realizim të projektit nga ana e përfituesit. Pas kërkesës sonë për informata rreth realizimit të projektit (22.02.2021), përfituesi ka njoftuar përmes e-mail-it se projekti ka pasur vështirësi dhe nuk është realizuar sipas afatit të planifikuar, por pritet të realizohet në muajt në vazhdim. Deri në kohën e përfundimit të auditimit (26.03.2021), auditori nuk ka pranuar ndonjë raport apo dëshmi se projekti është përfunduar. Gjithashtu, nuk janë përdorur formularët standard të vlerësimit të kërkesave siç përcaktohet me Rregulloren për subvencionim, që përfituesi kishte/nuk kishte obligime të papaguara tatimore ndaj Komunës, nuk kishte sjellë dëshmi që

konfirmon se nuk ka konflikt interesi dhe dëshmi që projekti nuk ishte financuar edhe nga fondet tjera.

Mungesa e kontrolleve adekuate në vlerësimin dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara është shkak i kësaj situate.

#### **Ndikimi**

Vlerësimi jo adekuat i projekteve rrezikon arritjen e qëllimit për mjetet e dhëna si subvencione. Mungesa e kontrollit për të monitoruar subvencionet ka reflektuar në financimin e projekteve që nuk janë realizuar dhe kjo dëmton financiarisht Komunën për shkak të mos ndërmarrjes me kohë të masave për shkëputje të kontratës dhe rikthim të mjeteve.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë një proces të rregullt dhe të besueshëm të vlerësimeve të dëmeve për kulturat bujqësore, dhe të shtoj masat e kontrollit gjatë fazës së vlerësimit të kërkesave. Po ashtu të rrisë mbikëqyrjen e projekteve të financuara nga subvencionet dhe në rast të mos realizimit të projekteve, Komuna duhet të ndërmarr masat për shkëputje të kontratës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 49,894,363€, prej tyre ishin shpenzuar 16,421,119€. Ato kanë të bëjnë me rregullim të infrastrukturës, qendrave sociale, çerdheve dhe përmirësime të ndryshme tek objektet arsimore etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 5,452,557€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja B6 - Ndarje jo e duhur e detyrave të punës

**Gjetja** Me Rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik, neni 62 pika 4 – përcaktohet se “një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit si dhe një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit”.

- Te kontrata “Furnizimi dhe vendosja e kamerave të sigurisë në kryeqytet”, me vlerë prej 78,299€, zyrtari përgjegjës që kishte hartuar specifikat teknike ishte emëruar edhe menaxher i kontratës; dhe
- Te kontrata “Ndërtimi i qendrës kulturore për të rinjtë – Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave”, me vlerë prej 424,257€, zyrtarja që ka marrë pjesë në komision të vlerësimit është emëruar edhe menaxhere e projektit.

Shkaku i ndodhjes se kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme nga zyrtarët përgjegjës.

**Ndikimi** Ndarja jo e duhur e detyrave përgjatë procesit të prokurimit rrit mundësin që të ketë favorizime të ndonjë operatori ekonomik të caktuar.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të siguroj se po zbatohen rregullat e vendosura të prokurimit sa i përket ndarjes së duhur të detyrave, duke eliminuar mundësin e angazhimit të zyrtarëve të njëjtë në detyra të cilat kanë konflikt interesi.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A4 - Tejkalim i pozicioneve të caktuara****Gjetja**

Sipas Rregullores dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik, pika 56.10 - “Mospërputhja e lejuar plus/minus (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull”.

Në dy raste kemi identifikuar se në disa pozicione ishte tejkaluar sasia/çmimi, mbi përqindjen e paraparë me kontratë (+/-30%). Njëra pagesë në vlerë 85,799€ për “Sanimin e gropave dhe deformimin e shtresave të asfaltit“ (te pozicioni 3.9 punimi i shtresës së re qarkulluese BZH 22 sipas kontratës ka qene 2,000m<sup>2</sup>, ndërsa sipas situacionit 8,360m<sup>2</sup>) dhe pagesa tjetër për kontratën “Rekonstruimi i rrugës Gazmend Zajmi dhe Ali Pashe Tepelena” prej 114,446€ (te pozicioni 2.2 furnizimi, bartja dhe ngjeshja e tamponit sipas kontratës ka qenë 982.21 m<sup>3</sup>, ndërsa sipas situacionit 3,631m<sup>3</sup>).

Menaxheret e projekteve nuk kishin treguar kujdes të duhur, apo ushtruar kontrollin gjatë pranimit të këtyre pozicioneve.

**Ndikimi**

Tejkalimi i pozicioneve të caktuara mbi limitet e paraparë me kontratë, rrisin rrezikun që projektet të mos realizohen siç kanë qenë të planifikuara.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura tek mbikëqyrja e projekteve kapitale janë funksionale. Po ashtu, të sigurojë që për menaxhim të kontratave të autorizohen personat e përgjegjshëm dhe kompetent, që sigurojnë se punët mbikëqyren dhe pranohen sipas kushteve të kontratës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## Çështja C1 - Periudhë jo valide e garancionit dhe nënshkrim i paautorizuar i raportit pranues

### Gjetja

Sipas kushteve të veçanta të kontratës të nënshkruar në mes të operatorit ekonomik dhe autoritetit kontraktues, kërkohet që kontraktuesi pasi të përfundoj projektin t'i ofrojë Komunës garancinë për tri vite, në rast të ndonjë defekti nëse paraqitet nevoja. Po ashtu me Vendimin e Kryetarit të Komunës caktohen një menaxher i kontratës dhe organi mbikëqyrës (dy apo tre mbikëqyrës), varësisht prej llojit të kontratës dhe natyrës së për çka është lidhur kontrata.

- Te kontrata kornizë “Lot 1- Fasadimi dhe gëlqerosja në shkolla dhe objekte komunale” me vlerë të kontratës prej 162,870€, Komuna nuk e kishte pranuar garancinë pas ekzekutimit të kontratës për tri vite. Nga ana e operatorit ekonomik ishte dorëzuar garancioni vetëm për një vit pas përfundimit të punëve.
- Tek pagesa me vlerë prej 85,799€, për kontratën “Sanimi i gropave dhe deformimi i shtresave të asfaltit” zyrtarët e caktuar me vendim të Kryetarit të Komunës si organ mbikëqyrës nuk kishin nënshkruar në raportin mbi kryerjen e punimeve. Këto raporte janë nënshkruar nga zyrtarët e pa autorizuar të cilët nuk kishin ndonjë vendim plotësues të ZKA-së, për të justifikuar këtë veprim.

Shkaku i ndodhjes ishte mungesa e mbikëqyrjes nga ana e menaxherit të kontratës, si dhe sipas dëshmive të ofruara nga zyrtarët përgjegjës kjo kishte ndodhur pasi zyrtarët që kanë qenë kompetent kishin qenë të angazhuar me punë të tjera.

### Ndikimi

Në raste të shfaqjes së ndonjë defekti pas përfundimit të projektit, shpenzimet për sanimin e gjendjes do të bart vetë Komuna, në mungesë të garancionit me afat tre vjeçar nga OE. Po ashtu, mungesa e nënshkrimit të zyrtarëve përgjegjës reflekton mungesë të kontrollit dhe mbikëqyrje të dobët në kryerjen/pranimin e punëve apo furnizimeve.

### Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit pranon garancionin pas përfundimit të projektit, me afat të vlefshëm sikurse është përcaktuar në kontratë. Gjithashtu të siguroj se organi mbikëqyrës respekton vendimin dhe zbaton kontrollet duke marr përgjegjësi për mbikëqyrje të projektit dhe duke nënshkruar raportin e pranimin. Në raste të caktuara mund të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## Çështja C2 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

### Gjetja

Në dy raste nuk ishin përfunduar punët sipas kushteve të kontratës, planit dinamik;

- Sipas Kushteve të veçanta të kontratës publike kornizë “Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugë dhe trotuare të Komunës së Prishtinës” me vlerë indikative prej 202,105€, neni 1, paragrafi 1.4 thekson se kontrata përfundon me dt.15.08.2020. Ndërsa sipas situacionit përfundimtar) me vlerë prej 85,799€, punët ishin përfunduar jashtë afatit të paraparë me kontratë apo me dt.13.11.2020 dhe se pagesa është bërë me dt.08.12.2020, duke mos ofruar ndonjë arsye për vonesën.
- Sipas kushteve të veçanta të kontratës për “Furnizimi me aparat CDM ” që ishte nënshkruar me dt.20.09.2019 me vlerë 221,000€, parashihet që realizimi i këtij projekti të jetë 60 ditë sipas afatit të liferimit. Sipas situacionit të fundit me dt.29.06.2020, furnizimi me këta aparate paraqet vonesa rreth nëntë muajve apo 270 ditëve në pranimin e furnizimit.

Konsiderojmë se shkak është mungesa e kontrolleve të brendshme.

### Ndikimi

Vonesat në kryerjen e punëve ndikojnë që objektivat e organizatës të arrihen me vonesë dhe ngarkon buxhetin e viteve vijuese.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuar, të aplikohen masat e parapara në kontratë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.5 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale;

### Çështja B7 - Vonesa në zotim, lëshim të urdhër blerjeve dhe pamjaftueshmëri e mjeteve

**Gjetja** Neni 36.1 i ligjit 05/L-063 LMFP, përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK në përputhje me rregullat KMF. Gjithashtu, neni 12 i Rregullës financiare 01-2013 për Shpenzimin e parasë publike, përcakton që - "Zotimi është njohje kontabël në SIMFK e një obligimi të mundshëm në të ardhmen për të bërë një shpenzim të parave publike".

- Kontrata “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë”, me vlerë prej 147,835€ është lidhur me datë 03.08.2020, ndërsa zotimi i mjeteve është bërë më 02.11.2020 në vlerë prej 29,569€, që nënkupton se zotimi është i pamjaftueshëm dhe është bërë pas afatit të kontratës.
- Për kontratën “Dezinfektimi i objekteve të kujdesit primarë shëndetësor në Komunën e Prishtinës dhe institucionet tjera komunale”, në vlerë prej 41,557€, zotimi i mjeteve në SIMFK ishte bërë pas 78 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, përkatësisht pas përfundimit të kontratës apo shërbimit të kryer.
- Gjithashtu, nga auditimi i 70 mostrave, në 33 raste kemi gjetur se zotimi i mjeteve në SIMFK dhe përgatitja e urdhër blerjeve ishin bërë pas pranimit të faturës apo pranimit të mallrave/shërbimeve.

Shkaku përse ka ndodhur kjo është mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes në menaxhimin e buxhetit dhe zotimit të mjeteve me kohë në SIMFK.

**Ndikimi** Vonesat në zotimin e mjeteve dhe lëshimit të urdhër blerjeve rrisin rrezikun e realizimit me kohë të kontratave dhe ekzekutimit të pagesave. Në mungesë të buxhetit, Komuna mund të jetë edhe subjekt i padive nga kontraktuesit dhe pagesat e tilla mund të bartin edhe kosto shtesë për shkak të mos realizim me kohë të detyrimeve.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurojë se zotimi i fondeve bëhet para hyrjes në obligime kontraktuale dhe urdhri për blerje duhet ti paraprijë furnizimit të mallrave apo shërbimeve me qëllim të funksionimit të kontrollit në realizimin e kontratave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2.6 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 2,485,567,982€, pasurive jokapitale është 1,134,590€, si dhe e stoqeve 582,279€. Kemi testuar 79 mostra për teste substanciale në vlerë prej 4,717,973€, ku 70 mostra janë për pasuritë mbi 1,000€ dhe nëntë mostra për pasuritë me vlerë nën 1,000€ si dhe në aspektin e pajtueshmërisë kemi kryer shtatë teste sipas programit të auditimit. Lidhur me menaxhimin e pasurive, ne kemi vërejtur si në vijim:

### Çështja C3 - Mos inventarizimi i pasurive jo financiare

**Gjetja** Sipas Rregullores me nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.6 dhe 4.7, kërkon që “Komisioni i inventarizimit të përgatitë raportin për kryerjen e inventarizimit” si dhe komisioni është përgjegjës gjithashtu që “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”. Ky proces duhet ti paraprij përgatitjes së PFV.

Komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të kryetarit të komunës me dt. 24.12.2020. Mirëpo, komisioni nuk kishte përgatitur ndonjë raport për gjendjen e inventarizimit para përgatitjes së PVF. Deri në kohën sa ishim në auditim pjesërisht ishte kryer inventarizimi në disa drejtori të Komunës.

Shkaku përse ka ndodhur kjo, është se komisioni ishte formuar në fund të vitit dhe nuk kishte kohë të mjaftueshme për ta përfunduar këtë proces.

**Ndikimi** Mos përgatitja e raportit të inventarizimit brenda afatit të paraparë, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe në pasqyrat financiar vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e pasurisë.

**Rekomandimi C3** Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë përgatit me kohë raportin për inventarizimin e pasurive apo para datës së përgatitjes së PFV-ve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.7 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 67,942,758€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në prone në vlerë prej 38,628,003€, lejet e ndërtimit në vlerë prej 13,433,976€, mbledhja e mbeturinave në vlerë prej 7,346,818€ dhe nga llogarit tjera të pa arkëtuar në vlerë prej 8,533,961€ (taksa rregullative e infrastrukturës, taksat në biznes, të arkëtueshmet nga shpronësimi, Drejtoria e shërbimeve publike dhe nga qiraja).

### Çështja B8 - Sfidat në menaxhimin apo arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, Komuna nuk po arrin të krijoj mekanizma për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Në fund të vitit 2020 të arkëtueshmet kishin arritur vlerën prej 66,524,099€. Kjo paraqet rritjen e të arkëtueshmëve për 32% apo 16,003,906€ në raport me vitin 2019 (që ishin prej 50,520,193€).

Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë në vlerë prej 38,004,400€<sup>8</sup>, të hyrat nga lejet e ndërtimit në vlerë 13,433,976€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 6,551,762€.

Si rezultat i mos vendosjes së mekanizmave për arkëtimin e këtyre llogarive ka ardhur deri te rritja e tyre.

**Ndikimi** Mungesa e masave konkrete për të arkëtuar të hyrat me kohë ka ndikuar në rritje të vlerës së llogarive të arkëtueshme duke reduktuar edhe mundësinë e Komunës të planifikoj projekte që mund të financohen nga këto fonde.

**Rekomandimi B8** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion si dhe të ndër marr masa ligjore për ti mbledhur këto llogari, të cilat do të shfrytëzohen për arritjen e objektivave të planifikuar nga këto fonde.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të komunikimit të veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit janë si në vijim:

#### **Çështja 1 Shpalosja e pa saktë e vlerës së llogarive të arkëtueshme në PFV**

**Gjetja** Llogaria e arkëtueshme e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 1,418,658€, ky mbivlerësim ka të bëjë me:

Llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë ishin mbivlerësuar për 623,602€. Kjo sepse Komuna ka prezantuar këtë llogari në vlerë prej 38,628,003€, ndërsa do duhej ta prezantonte në vlerë prej 38,004,400€.

Saldo fillestare (01.01.2020) e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë ishte 34,558,800€, duke i shtuar faturimet e këtij viti (për objekte dhe parcela), gjendja për vitin 2020 do të duhej të ishte 9,666,083€, minus pagesat e ndodhura gjatë vitit prej 6,220,483€, gjendja e saktë që do të duhej të prezantohej në PFV, për këtë llogari është 38,004,400€; dhe

Llogaria e arkëtueshme për taksën e mbeturinave është mbivlerësuar për 795,056€, për arsye se në këtë llogari janë përfshirë edhe ngarkesat (faturimet) e tre muajve të parë të vitit 2021.

**Veprimi i kërkuar** Ne kemi sugjeruar Komunën të ndërmarrë veprime të nevojshme që të bëhen korrigjimet në PFV në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme të shpalosen saktë dhe drejtë.

**Rezultati** Komuna me dt.21.07.2021 ka korrigjuar PFV për vitin 2020, të cilat ishin aprovuar nga Ministria e Financave (Thesari), dhe konsiderojmë se shpalosja e vlerës së llogarive të arkëtueshme në këto pasqyra është e saktë dhe e plotë.

## 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve nga kategoritë ekonomike dhe të hyrat e mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>9</sup>	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>91,579,504.00</b>	<b>119,429,484.86</b>	<b>72,916,837.01</b>	<b>78,648,130.00</b>	<b>61,331,462.04</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	62,321,137.00	61,144,638.33	51,368,531.91	51,327,902.00	41,646,451.35
Financimi përmes huamarrjes	0.00	1,452,629.80	1,308,767.65	18,063.25	473,026.98
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	27,473,465.55	11,450,252.46	13,212,060.40	4,426,155.15
Të hyrat vetanake	29,258,367.00	29,258,367.00	8,709,543.39	14,073,880.45	14,697,391.48
Donacionet vendore	0.00	646.10	0.00	6,766.20	2,468.90
Donacionet e jashtme	0.00	99,738.08	79,741.60	9,457.70	85,968.18

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 27,849,981€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, huamarrja dhe nga donacionet e jashtme.

Në vitin 2020, Komuna e Prishtinës ka shpenzuar 61% të buxhetit final ose 72,916,837€, me një përqindje më të vogël se sa në vitin 2019 ku kishte shpenzuar 71% të buxhetit. Megjithatë, se si është realizuar buxheti në nivel të kategorive, janë dhënë shpjegimet në tabelën më poshtë:

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>91,579,504.00</b>	<b>119,429,484.86</b>	<b>72,916,837.01</b>	<b>78,648,130.00</b>	<b>61,331,462.04</b>
Pagat dhe mëditjet	31,803,062.00	30,903,079.53	30,893,484.67	30,008,502.57	29,420,508.17
Mallrat dhe shërbimet	19,111,479.00	22,661,142.45	18,711,441.53	15,594,152.84	11,618,992.24
Komunalitë	2,000,000.00	2,000,000.00	1,829,705.32	2,351,818.70	1,784,546.50
Subvencionet dhe transferet	3,780,900.00	13,670,900.00	5,061,086.35	11,847,911.14	1,713,940.79
Investimet Kapitale	31,885,008.00	49,894,362.88	16,421,119.14	18,845,744.75	16,793,474.34
Rezervat	2,999,055.00	300,000.00	0.00	0.00	0.00

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 899,982€ sipas Vendim të Qeverise për kursim të mjeteve.
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti final në raport me atë fillestare është rritur për 3,549,663€. Rritja është nga të hyrat e bartura për 1,760,000€, nga huamarrja prej 934,717€, me vendimet Qeverise në emër të Covidit prej 656,127€, nga donacionet e jashtme vlere prej 3,898€, si dhe nga transferimi i rezervës në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 194,921€.
- Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve kishte rritje të buxhetit final në raport me atë fillestar për 9,890,000€. Buxheti është rrit nga bartja e të hyrave prej vitit të kaluar në vlerë prej 2,390,000€, bartja e fondeve nga kategoria e rezervës prej 2,000,000€ dhe me Rishikim të ligjit të buxhetit Komuna ka përfituar edhe 5,500,000€. Nga buxheti prej 13,670,900€ Komuna ka arrit të shpenzoj vetëm 37% për shkak se në fund të vitit nuk kishte bërë pagesat për subvencionimin e bizneseve, e planifikuar si ndihmë për rimëkëmbje ekonomike.
- Po ashtu, edhe buxheti final për kategorinë e investimeve kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 18,009,355€. Kjo rritje ishte prej të hyrave të bartura nga viti i kaluar vlere prej 23,323,465€, si dhe donacioneve në vlerë 90,708€, ndërsa me rishikim të buxhetit investimet kapitale janë zvogëluar për 5,404,818€. Buxheti final për investime kapitale ishte në vlerë prej 49,894,363€, i cili ishte shpenzuar vetëm 16,421,119€ apo 33%. Trend i ulët i shpenzimit të buxhetit, dëshmon mos angazhimin e Komunës për t'i planifikuar, menaxhuar dhe mbikëqyrur realizimin e projekteve kapitale. Gjithashtu edhe fillimi i projekteve pa i zgjidhur çështjet pronëso-ro-juridike, pastaj vonesat në inicimin e procedurave të prokurimit, ankesat në OShP si dhe vonesa në realizimin e punimeve, pandemia ishin arsytet e realizimit të ultë të buxhetit për këtë kategori.
- Bazuar në Ligjin e buxhetit, komuna kishte përfituar fonde në vlerë prej 2,999,055€ për kategorinë e “Rezerva”, që me vendim të Ministrit mund të bartet tek kategoria e pagave dhe shtesave, në varësi nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Për shkak se Ligji i pagave nuk ka hyr në fuqi mjetet janë bartur për tu shpenzuar në kategoritë tjera si te: subvencionet 2,000,000€, te mallrat dhe shërbimet 197,260€ dhe te pagat dhe mëditjet 501,795€. Buxheti final për kategorinë e rezervave kishte mbet si i pa shpenzuar në vlerë prej 300,000€.
- Duhet të theksojmë se me Ligjin për Prishtinën, Komuna në vitin 2020 ka përfituar buxhet shtesë në vlerë prej 11,777,096€, të cilat janë shpërndarë në kategoritë ekonomike si në vijim: investime kapitale 5,000,000€, mallra dhe shërbime 3,777,096€, paga dhe mëditje 1,000,000€ si dhe subvencione dhe transfere 2,000,000€.


Shpenzimet e Komunës për menaxhimin e emergjencave nga COVID-19 dhe rimëkëmbje ekonomike ishin në vlerë prej 3,098,179€. Këto janë shpenzuar për: shtesat në paga 1,568,595€, mallra dhe shërbime 801,175€ dhe subvencione 728,409€.

Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2020, janë në vlerë prej 34,347,176€ (kjo e dhënë është ofruar nga ana e Komunës).


Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2020, ishte 6,790,497€, këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2020, ishte 32,217,672€. Prej kësaj vlere, shumica e lëndëve kanë të bëjnë me kompensim dëmi ndaj qytetarëve, pastaj lëndët tjera që kanë të bëjnë me çështjet pronësore, administrative, banesore, penale etj.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Buxheti i planifikuar i të hyrave vetanake për vitin 2020 ishte 29,258,367€, kurse realizimi ishte në vlerë prej 24,963,214€ (një realizim prej 85%). Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga dhënia në shfrytëzimin e pronës komunale, etj. Vlen të theksohet se në këtë vit krahasuar me vitin e kaluar, Komuna ka realizuar më pak të hyra prej 4 milion euro apo shprehur në përqindje 14%. Zvogëlimi më i theksuar është tek tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, si dhe shfrytëzimi i hapësirës publike.

Po ashtu, Komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat në trafik, gjykatat dhe agjencia e pyjeve në vlerë totale prej 2,072,880€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>29,258,367.00</b>	<b>29,258,367.00</b>	<b>24,963,214.08</b>	<b>28,891,066.98</b>	<b>26,283,646.03</b>
Të hyrat tatimore	9,139,671.00	9,139,671.00	6,220,482.64	7,601,296.72	6,975,295.25
Të hyrat jo tatimore	20,118,696.00	20,118,696.00	18,615,901.27	21,288,809.43	19,307,109.78
Të hyrat tjera	0.00	0.00	126,830.17	960.83	1,241.00

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar me 23 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu Komuna kishte raportuar për progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, shtatë rekomandime janë zbatuar, tre ishin në proces dhe tetë nuk janë zbatuar ende, si dhe pesë rekomandime konsiderohen si të mbyllura, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak






Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që vlerësuesit bëjnë inspektimet e sakta të gjendjes në terren në mënyrë që ngarkesat tatimore të bëhen në përputhje me dhjetë zonat e qytetit të përcaktuara në rregulloren e tatimit në pronë.	Komuna ka ndërmarrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që në mënyrë sistematike bëhet verifikimi i objekteve në teren, në mënyrë që pronat të vlerësohen dhe faturohen në pajtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.	Komuna ka ndërmarrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që janë duke u respektuar afatet ligjore me rastin e lëshimit të lejeve të ndërtimit, kur kërkesat janë plotësuar nga organet kompetente që kanë bërë kërkesën për lejen ndërtimore.	Nuk janë ndërmarrë masa për shqyrtimin me kohë të kërkesave për LN. Gjithashtu edhe tek LMK është e njëjta gjendje.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore	Komuna nuk ka ndërmarrë masa lidhur me këtë rekomandim, çështja është prezantuar tek B3.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Të hyrat	Kryetari, duhet të merr masa të shpejta në procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale, përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe formave tjera ligjore që qojnë drejt arkëtimin e të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa lidhur me këtë çështje. Kjo çështje është prezantuar tek B3.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Të hyrat	Kryetari të ndërmarrë masa se të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal, faturohen në baza të rregullta dhe merren	Komuna ka marrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar

		të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.		
8.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për pozita të rregullta dhe afatgjata të punës, aty ku është e nevojshme, të adresohen në MF përmes planifikimeve adekuate buxhetore, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent.	Me hyrjen në fuqi të Ligjit për zyrtarët publik ka ndryshuar kriteri i gjetjes.	Nuk është i aplikueshëm më
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth implementimit të kontratave.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitja e Planit Vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të bëhet brenda afatit të kërkuar me rregullore. Njëherit, të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim gjatë procesit përzgjedhës duke siguruar më tutje monitorim të vazhdueshëm për projektet e financuara.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa lidhur me këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termat e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Komuna ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët e organit mbikëqyrës të emëruar me vendim të kryetarit, janë duke e mbikëqyrur dhe të njëjtit nënshkruajnë raportin mbi kryerjen e punimeve. Në raste të caktuara të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.	Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur, sepse është trajtuar te çështja C1.	Nuk është i aplikueshëm më
14.	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe	Komuna edhe me tutje ka probleme me vonesat në realizimin e projekteve.	Pjesërisht i zbatuar

		ato të realizohen sipas planit dinamik.		
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek vlerësimi i ofertave në mënyrë që të respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, si dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të jenë njerëz kompetente me njohuri të fushës përkatëse.	Komuna ka ndërmarrë masa për këtë çështje, dhe nuk kemi identifikuar raste tjera të ngjashme.	I zbatuar
16.	Investimet kapitale	Kryetari i komunës duhet të sigurojë se pasi të përfundohet projekti është pranuar garancioni për punët e kryera nga ana e operatorit ekonomik ashtu siç është përcaktuar në kontratë.	Komuna nuk ka marrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim.	Pjesërisht i zbatuar
17.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhër-blerjes.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
18.	Pasuritë	Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare.	Menaxhmenti ka ndërmarrë masa duke themeluar komisionin për inventarizim të pasurive, por raporti për të gjitha drejtoritë nuk është përgatitur.	Pjesërisht i zbatuar
19.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
20.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpalojë saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.	Menaxhmenti ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
21.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha masat në dispozicion, si dhe masat ligjore për të mbledhur këto borxhe, të cilat po i shkaktojnë humbje financiare komunës prej vitit në vit.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin

22.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrolle të brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjorë prej 30 ditësh.	Menaxhmenti ka ndërmarrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
23.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.	Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur, këtë çështje e kemi dërguar në Letër menaxhment.	Nuk është i aplikueshëm më

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me zyrtarin e pasurive, në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të merren të gjitha veprimet e nevojshme në bashkëpunim me ministrin e linjës për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të monitoroj se procesi i inspektimit/verifikimit të pronave bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu duhet të siguroj se politikat e komunikimit me palët e interesit/tatimpaguesit janë duke funksionuar me qëllim të azhurnimit të bazës me të dhëna të sakta sa i përket aplikimit/mos aplikimit të zbritjeve të lejuar sipas kërkesave ligjore.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se zyrat përgjegjëse kanë staf të mjaftueshëm në dispozicion dhe shqyrtimi i kërkesave për leje mjedisore dhe atyre ndërtimore bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në të kundërtën duhet të shqyrtohet mundësia e angazhimit të kuadrove shtesë në këto departamente.
4.	Të hyrat	Kryetari, duhet ti përmbahet zotimeve sipas planit të veprimit të përgatitur nga vet Komuna që çështja e këtyre pronave të zgjidhet duke përdor të gjitha mundësit ligjore për menaxhimin e këtyre pronave. Të siguroj se pronat komunale do të ofrohen në shfrytëzim nëpërmes një procesi transparent që do të rezultojë me kontrata valide, dhe Komunës si titullar i pronës publike duhet ti sjellin përfitime maksimale.
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që të mos realizohen pagesa pa kontratë publike. Lëndët të kompletohen me dokumentacionin e nevojshëm para se ato të dërgohen për pagesë. Pranimi i mallrave dhe shërbimeve të bëhet nga zyrtarët e autorizuar për menaxhim dhe mbikëqyrje të kontratave.
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret në rrethana të arsyeshme sipas LPP, duke eliminuar mundësin e diskriminimit të operatoreve. Për shërbimet e sigurimit, me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës të negociojë termat e kontratës me më shumë operator ekonomik që në treg ofrojnë shërbimin e njëjtë.
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë një proces të rregullt dhe të besueshëm të vlerësimeve të dëmeve për kulturat bujqësore dhe të shtoj masat e kontrollit gjatë fazës së vlerësimit të kërkesave. Po ashtu të rrisë mbikëqyrjen e projekteve të financuara nga subvencionet dhe në rast të mos realizimit të projekteve, Komuna duhet të ndërmarr masat për shkëputje të kontratës.

8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-te, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se po zbatohen rregullat e vendosura të prokurimit sa i përket ndarjes së duhur të detyrave, duke eliminuar mundësin e angazhimit të zyrtarëve të njëjtë në detyra të cilat kanë konflikt interesi.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit pranon garancionin pas përfundimit të projektit, me afat të vlefshme sikurse është përcaktuar në kontratë. Gjithashtu të siguroj se organi mbikëqyrës respekton vendimin dhe zbaton kontrollet duke marr përgjegjësi për mbikëqyrje të projektit dhe duke nënshkruar raportin e pranimit. Në raste të caktuara mund të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuar, të aplikohen masat e parapara në kontratë.
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroje se kontrollet e vendosura tek mbikëqyrja e projekteve kapitale janë funksionale. Për menaxhim të kontratave të autorizohen personat e përgjegjshëm dhe kompetent, që sigurojani se punët mbikëqyren dhe pranohen sipas kushteve të kontratës.
13.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se zotimi i fondeve bëhet para hyrjes në obligime kontraktuale dhe urdhri për blerje duhet ti paraprijë furnizimit të mallrave apo shërbimeve me qëllim të funksionimit të kontrollit në realizimin e kontratave.
14.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë përgatit me kohë raportin për inventarizimin e pasurive apo para datës së përgatitjes së PFV-ve.
15.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion si dhe të ndërmarr masa ligjore për ti mbledhur këto llogari, të cilat do të shfrytëzohen për arritjen e objektivave të planifikuara nga këto fonde.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Lavdim Maxhuni, Udhëheqës i ekipit




Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Ilir Abazi, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
		
<p><b>LETËR E KONFIRMIMIT</b></p>		
<p>Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>		
<p><b>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit</b></p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none"><li>• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);</li><li>• pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe</li><li>• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.</li></ul>		
<p>z. Shpend Ahmeti</p>		
<p>Kryetar i Komunës së Prishtinës</p>		
<p>Data: 15.07.2021, Prishtinë</p>		

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>10</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>11</sup>. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.



## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

## Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

### *Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik.
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet.
- 4 Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja.  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura.  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- 5 Për shkak të mos aplikimit të zbritjes prej 15,000€ për banimin parësor një tatimpagues dëmtohet apo ngarkohet padrejtësisht me vlerë me të lartë prej 22.50€. Në rastin kur janë identifikuar 350 prona që nuk ju ka lejuar kjo zbritje, Komuna ka mbi faturuar tatimpaguesit për  $350 * 22.5 = 7,875$ €. Tre tatim paguesit tek të cilët është bërë nën faturimi për arsye të aplikimit të zbritjeve të palejuara të banimit, edhe atë: Tatimpaguesi 1 - posedon 15 prona të banuara dhe në të gjitha 15 ka bërë zbritja prej 15,000€, çka do të thotë ka bërë 14 zbritje të palejuara, atëherë kemi:  $14 * 22.5 = 315$ € (nën faturim). Tatim paguesi 2 - i ka 8 prona të banuara dhe në të gjitha 8 ka bërë zbritjen, çka do të thotë ka bërë 7 zbritje të palejuara, atëherë kemi:  $7 * 22.5 = 157.5$ €. Dhe tatimpaguesi 3 - i ka 42 prona të banuara (sepse zbritja aplikohen vetëm se për pronat e banuara, e jo për pronat komerciale) dhe në të gjitha këto 42 prona ka bërë zbritja, do të thotë 41 zbritje të palejuara, atëherë kemi:  $41 * 22.5 = 922.5$ €. Atëherë kur i mbledhim të gjitha këto 3 shuma 62 zbritje të palejuara, fitojmë:  $315 + 157.5 + 922.5 = 1,395$ €-nën faturim.
- 6 Gjendja e llogaris së pa arkëtuar e prezantuar në PFV është e njëjtë sikurse vitin e kaluar pasi Komuna nuk ka faturuar me pretekstin se këto janë kontrata të skaduar.
- 7 Përveç ndryshimit të hapësirës për këto dy shkolla, ishin bërë korrigjime të duhura të hapësirave edhe për shkollat tjera (3,679m<sup>2</sup>), kjo si rezultat i kalkulimit të gabuar në dosjen e tenderit. Në total ndryshimi i aprovuar i hapësirave të brendshme ishte 8,266 m<sup>2</sup> apo në vlerë 3,802€ për muaj. Para vitit 2020, shpenzimet e arkivimit të këtyre dokumenteve e kishte paguar BQK, pasi kjo e fundit kishte marrë në shfrytëzim objektin në pronësi të Komunës, në të cilën ishin të vendosura dokumentet. Neve na është ofruar kontrata mes BQK-së dhe OE, e cila kishte skaduar në fund të vitit 2019. Vendimi nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim të objektit në pronësi të komunës për BQK-në ishte marrë më datë 12.10.2018.
- 8 Borxhi i lartë i tatimit në pronë përfshin në vete borxhet nga NSH(AKP), vlera e së cilës në fund të vitit 2020 kap shumën prej 12,128,383€ (që përfshin 30% nga totali). Vlera prej 2,697,617€ janë të arketueshmet nga NSH "Rilindja" dhe të arketueshmet nga pronat fiktive (NN) në sistemin e protaxit që kapin shumën prej 313,274€ dhe pjesa tjetër është borxh nga qytetarët. [2] inkasimi në raport me faturimin për mbeturina në vitin 2020 është 47.66%, kurse janë rreth 72,280 amvisni, të cilat kur i shumëzojmë me 52.34%, del shuma prej 37,831€ amvisni, të cilat janë faturuar, por që nuk kanë paguar gjatë vitit 2020.
- 9 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.
- 10 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit.
- 11 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.